

NURI DRAGOJ

**LUFTA E PËRMETIT. DJEGIA DHE PASOJAT
(KORRIK 1943)**

Në këtë artkull, jam përpjekur të paraqes shkaqet e djegies së qyteteve Përmet dhe Këlcyrë, në korrik të vitit 1943, prej forcave ushtarake italiane, pasojat që rrodhën nga djegia e tyre, si dhe debatet e zhvilluara midis forcave politike të kohës, për mënyrën e veprimit. Në mesin e vitit 1943, rezistenca antiitaliane ishte rritur, për pasojë, pushtuesi kishte intensifikuar dhunën ndaj popullit, si mjete i vetëm për nënshtrimin e tij. Ndërkohë, forcat në radhët e Frontit Antifashist ishin shtuar dhe midis partive politike shqiptare bëheshin përpjekje për bashkim në një front të vetëm. Besoj, që me këtë trajtesë, ndonëse e rrafshit lokal dhe në kornizat e një artikulli, bazuar kryesisht në dokumente arkivore, mund t'i shërbejë sado pak historiografisë shqiptare, pasi rreth këtij problemi trajtesat kanë qenë të cinguara.

Pse u zgjodh Përmeti për të sulmuar forcat italiane?

Pas sulmit ndaj Pezës më 3 qershor 1943, në planet ushtarake të trupave italiane ishte vendosur zona e Mallakastrës dhe Tepelenës, në të cilat rezistenca antiitaliane ishte më e fuqishme. Ky plan shqetësoi komandën partizane, e cila vendosi të intensifikonte sulmet ndaj garnizoneve italiane në disa pika strategjike, për ta çorientuar atë dhe shmangur goditjen ndaj forcave shqiptare në zonat e mësipërme. U mendua se goditja më efektive do të ishte sulmi ndaj garnizoneve ushtarake të Përmetit.

U zgjodh Përmeti, për shkak se pozicioni i ushtrisë italiane në atë rreth, shihej me rëndësi edhe nga vetë pushtuesit. Ai kishte dhe statusin e një “nyje lidhëse për tre qarqet e jugut: Korçë, Berat e Gjirokastrë”.¹ Në aspektin strategjik dhe ushtarak, të tillë e vlerësonin edhe partizanët, të cilët me këtë aksion, synonin të bënin të papërdorshme për forcat italiane,

¹ *Përmeti gjatë Luftës Nacionalçlirimtare 1939-1944*, Tiranë: 1970, f. 217, Përgatitur nga Kristo Frashëri, Mikail Kote dhe Vasil Thomollari. Ruhet në Muzeun Historik të Përmetit.

dy rrugët kryesore, Berat-Përmet-Perat* dhe Korçë-Ersekë-Leskovic. Në këtë mënyrë, vihej nën kontroll dhe rruga Tepelenë-Përmet. Aksionin e favorizonte edhe rritja e numrit të luftëtarëve shqiptarë, pranimi i luftës nga të gjitha palët dhe përpjekjet që po bëheshin nga forcat politike, për t'u bashkuar në një front të vetëm. Kjo përkonte me kohën, kur Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar kishte vendosur të mblidhej në Labinot, më 4 korrik 1943, për të formuar Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë NAÇL.² Ndërsa Konferenca e Labinotit, do të hidhte idenë e zgjerimit të frontit dhe kalimin nga faza e çetave, në atë të batalioneve dhe formacioneve të tjera më të mëdha ushtarake.³

Qëllimi i luftëtarëve shqiptarë ishte largimi i italianëve nga Përmeti, sepse krijimi i zonave të lira në këtë rajon, shërbente për një organizim me të mirë të ushtrisë shqiptare në të ardhmen, pasi dominoheshin pikat strategjike prej tyre.

Partizanët ndiheshin të sigurt në fitore dhe ishin më të motivuar moralisht, ngaqë luftonin për mbrojtjen e vendit të tyre dhe kishin mbështetje popullin. Suksesin e bazonin, gjithashtu, edhe në pozicionin gjeografik të këtij rrethi. Në Përmet, mund të hyje nga Gjirokastra dhe Tepelena, vetëm nëpërmjet grykës së ngushtë të Këlcyrës, dhe nga Berati, nëpërmjet Qafës së Këçokut, të cilat, sipas partizanëve, kontrolloheshin lehtësisht prej tyre. Krerët e çetave partizane, ishin të mendimit, se duke sulmuar nga të gjitha anët dhe bllokuar ardhjen e ndihmave nga këto pika, batalionet italiane nuk kishin rrugë tjetër, veç dorëzimit pa kushte.⁴

Por, përkundër këtyre hamendësive, përfaqësues të Ballit Kombëtar, mendonin se nuk duhej nxituar, pasi forcat italiane ishin ende të fuqishme dhe nuk mund të dorëzoheshin lehtë. Sipas tyre, para se të sulmoheshin italianët, duhej të merreshin masa për mbrojtjen e banorëve. Nuk mund të lejohej asnjë keqlllogaritje që mund të bëhej shkak për humbjen e jetëve njerëzore.⁵ Megjithatë, pas këmbënguljes së partizanëve, disa prej çetave balliste pranuan të merrnin pjesë në luftime.

* Perat - fshat në rrugën Përmet - Tri - Ura, në afërsi të kufirit shqiptar me atë grek.

² *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, grup autorësh, përgatiti për botim prof. dr. Xhelal Gjeçovi, Tiranë: "Toena", 2009, f. 62.

³ *Po aty*, f. 69.

⁴ *Përmeti gjatë luftës..*, f. 221.

⁵ *Po aty*, f. 223.

Italianët, ndiheshin të fortë në aspektin ushtarak, por moralisht kishte filluar të vihej re rënie e dukshme, për shkak se në jug të tokës së tyre kishin zbarkuar aleatët dhe qeveria e Musolinit ishte në prag të largimit të saj. Goditjet e njëpasnjëshme nga ana e forcave shqiptare, kishte rritur shkallën e nervozizmit, gjë që manifestohej me presionin dhe dhunën e ushtruar në popull. Ata nuk dëshironin të linin Përmetin, sepse ikja prej andej, nënkuptonte largimin drejt bregdetit. Njëkohësisht ndiheshin të sigurt, pasi në pikat ku ishin instaluar garnizonet e tyre, kishin ngritur struktura mbrojtëse të betonuara. Duke pasur një ushtri profesioniste dhe sistem mbrojtës të garantuar, besonin, se nuk mund të dëmtoheshin nga sulmet partizane, të cilët shiheshin si amatorë në fushën e luftimit. Duke qenë pikë e tillë strategjike, të dy palët ishin të mendimit, se nuk mund të goditeshin lehtë nga kundërshtari. Pikërisht, për këtë shkak, italianët dhe luftëtarët shqiptarë, ishin vënë në përgjim, duke ndjekur me vigjilencë çdo lëvizje të njëri - tjetrit.

Organizimi i operacionit (1-5 korrik 1943)

Komanda* dhe Shtabi Operativ i këtij operacioni, takimin e parë e bëri në Badlonjë, ndonëse qendrën komanda e pati në Lupckë dhe më vonë në Velçisht, ku kishte më shumë mundësi komandimi e kontrolli. Më 25 qershor 1943, erdhën forca të reja nga rrethet e tjera dhe Këshilli i Rrethit Përmet, kishte marrë masa për strehimin dhe ushqimin e tyre.

Baza më e fuqishme e artilerisë italiane ndodhej në Kuqar**, ndaj shtabi i operacionit kishte vendosur, që sulmi kryesor të përqendrohej pikërisht aty. Njëkohësisht, do të sulmohej edhe komanda e Përmetit, Këlcyra e Kiçoku, me qëllim që armiku të çoroditej krejtësisht. Ndërkohë, ishin marrë masat e duhura, që të gjitha pikat periferike të ishin nën mbrojtjen e forcave vullnetare, për të penguar ardhjen e

* Eshtë fjala për Komandën e Shtabit të Operacionit të Përmetit, në të cilën bënin pjesë: Teki Kolaneci, Raqi Themeli, Petrit Dume, Misto Treska, Nexhip Vinçani, Pëllumb Dëshnica, Tahir Kadareja, Bexhet Mema, Zylyftar Veleshnja, Neshat Hysi, Mestan Ujaniku dhe Ramiz Aranitasi. *Përmeti gjatë luftës nacionalçlirimtare ...*, f. 239.

** Kuqari, fshat në rrugën Këlcyrë-Përmet, 5 km nga Këlcyra, rreth 1 km në të djathtë të rrjedhës së Vjosës.

reparteve të armatosura italiane, në ndihmë të garnizoneve të rrethuara, në Përmet e Kuqar.⁶

Plani mendohej se ishte studiuar mirë dhe më 30 qershor, çetat partizane dhe njësitet territoriale, prenë në të katër anët linjat telegrafike, duke bërë të pamundur komunikimin e qytetit të Përmetit me rrethet e tjera të vendit.⁷ U prishën dhe rrugët e komunikacionit automobilistik, Berat - Përmet - Perat dhe Korçë - Ersekë - Leskovik, që lidhnin Shqipërinë me Greqinë.

Forcat italiane përbëheshin nga dy batalione, njëri i vendosur në Përmet dhe tjetri në Kuqar, pa llogaritur forcat e karabinierisë në dy qytetet, Përmet dhe Këlcyrë. Ndërsa në frontin partizan, për realizimin e këtij aksioni, përveç çetës “Musa Fratari”, çetës së Rëzës dhe asaj të Dëshnicës, që përbënin rreth 300 partizanë, u angazhuan forca nga Berati, Korça, Gjirokastra e Përmeti.⁸

Operacioni, që do të fillonte në katër pikat kyçe, Grykë e Mezhgoranit, Kiçok, Kuqar e Përmet, u zhvillua njëkohësisht nga data 1 deri në 5 korrik, ndaj dhe trajtimin e tij, po e japim shkurtimisht, hap pas hapi, pa e ndarë njërën betejë nga tjetra.

1 korrik 1943. Si fillim i aksionit mund të konsiderohet sulmi në Grykën e Këlcyrës, prej çetave partizane “Musa Fratari” dhe “Koto Hoxhi, ndaj një autokolone italiane.⁹ Në mbështetje të tyre ishin dërguar dhe partizanë të Skraparit, nën komandën e Xhemal Malindit*. Ndërkohë, rruga nga Dragoti deri në Këlcyrë ishte minuar në disa pika me rëndësi të saj.¹⁰ Komanda italiane, e informuar për këtë sulm, nisi një autokolone nga Gjirokastra drejt Këlcyrës, të përbërë nga 5 makina me ushtarë, 1 autobлиндë dhe një motoçikletë.¹¹ Në të njëjtën ditë, në Grykën e

⁶ Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: AIH), A-VIII-140, Buletin i Luftës Nacionalçlirimtare, Qarku Gjirokastrë, Viti 1943, f. 46.

⁷ AIH, A-VIII-140, Buletin i Luftës Nacionalçlirimtare, Qarku Gjirokastrë, Viti 1943, f. 50.

⁸ *Përmeti gjatë luftës...*, f.217.

* Xhemal Malindi - komandant i një çete të Skraparit.

⁹ AIH, A-VIII-72, Buletin i Luftës Nacionalçlirimtare, Qarku Gjirokastrë, Viti 1943, f. 30.

¹⁰ Xhelal Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë* (kujtme historike 1912-1966), Tiranë: “Naimi”, 2012, f. 247.

¹¹ AIH, A-VIII-140. Buletin i Luftës Nacionalçlirimtare, Qarku Gjirokastrë, Viti 1943, f. 52.

Mezhgoranit, forcat partizane goditën një togë ushtarësh italian, që kishin për qëllim lirimimin e rrugës Këlcyrë – Tepelenë, në dobi të forcave që po u vinin në ndihmë.¹² Lidhur me luftimet e Këlcyrës, shtabi i operacionit informohej, se në ora 3 të mëngjesit, në Grykën e Këlcyrës, për shkak të minimit të rrugës nga partizanët, motoçikleta që kryesonte autokolonën u hodh në erë, ndërsa ndalën në vend 5 kamionë me ushtarë dhe 1 autobлиндë.¹³

Ndërkohë, luftëtarët shqiptarë kishin rrethuar në fshehtësi forcat ushtarake italiane në Kuqar të Përmetit dhe në 20³⁰, pas një sinjali të dhënë nga komanda, mbi 600 forca sulmuan drejt tyre. Komanda e Përmetit raportonte e shqetësuar, se forcat rebele kishin sulmuar befasisht forcat ushtarake të instaluar në vendin e quajtur “Ripa e Kuqarit”, 15 km larg qytetit të Përmetit.¹⁴ Garnizonit italian, iu deshën disa minuta të zinte pozicionet në llogore. Por, mbrojtja në këto fortifikata të fuqishme, dhe numri i madh i ushtarëve, i dha mundësi garnizonit të Kuqarit të bënte një rezistencë të ashpër.¹⁵ Në një dokument të kohës thuhet, se sulmi u bë prej 7 çetave partizane, ku bënin pjesë ajo e Devollit, Kolonjës, Leskovikut, Moravës, Zagorisë, Skraparit dhe Përmetit, me një fuqi prej 900-1000 vetë.¹⁶

Në të njëjtën orë, u organizua dhe sulmi mbi Garnizonin Ushtarak të Përmetit. Ushtria italiane, që ndodhej në kazerma, nën komandën e

¹² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi (më tej: F.) 152, viti (më tej: V.) 1943, dosja (më tej: D.) 96, fl. 1. Shkresë e kryetarit të komunës Këlcyrë, Dhimosten Peti, Nr. Extra, dt. 13.07.1943, dërguar prefekturës Gjirokastrë. Prefektura e nis në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Prot. Nr. 51/131, dt. 15.7.1943.

¹³ *Po aty*, F. 67/APL. V. 1943. D. 5, fl.13. Informacion i Komandës së Vendit Përmet, dërguar Shtabit të Operacionit, datë 1.07.1943.

¹⁴ *Po aty*, F. 153, V. 1943, D. 295, fl. 99. Procesverbal i Komandës së Xhandarmërisë Përmet, mbajtur ditën e mërkurë, datë 7 korrik 1943, në zyrën e sekretarisë, firmosur dhe nga zëvendësnënprefekti Xhaferr Mehmet. Procesverbali i dërguar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë Tiranë.

¹⁵ Xhemil Frashëri, *Lufta e armatosur e popullit shqiptar*, Tiranë: “Vatra”, 2005, f. 120.

¹⁶ *AQSH*, F. 153, V. 1943, D. 295, fl. 99. Procesverbal mbajtur ditën e mërkurë, datë 7 korrik 1943, ora 10, në zyrën e sekretarisë së Komandës së Rrethit të Xhandarmërisë, firmosur dhe nga zëvendësnënprefekti Xhaferr Mehmet. Procesverbali i dërguar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë Tiranë, e cila ia përcjell Ministrisë Brendshme.

major Lesite Manfredo, u vendos në llogoret dhe fortifikimet e përgatitura më parë dhe iu përgjegj forcave sulmuese, pas pak minutash, “tue çel zjarm me armë të ndryshme kundra tyre”.¹⁷

Njësitë territoriale partizan, i përbërë nga forcat e Skraparit, të drejtuara nga Shaqir Kapinova, i ndërpreu ujin e pijshëm garnizonit të Përmetit, duke sharruar tubacionin që e sillte atë nga Dhëmbeli. Në një informacion, që i dërgohej Kryeministrit nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), thuhej, se krahas sulmeve të organizuara në Kiçok, Grykë të Këlcyrës dhe Kuqar, Shtabi i Operacionit e kishte përqendruar vëmendjen te rrethimi i garnizonit të Përmetit. Forcat partizane e kishin qarkuar atë nga kodrat për rreth dhe herë pas here e sulmonin, duke e detyruar të qëndronte i mbyllur brenda dhe për “t’iu imponue ushtarëve dorëzimin, ju kanë pre dhe ujin e pijshëm”.¹⁸

Duke parë gjendjen e rëndë të krijuar në qytet, panikun dhe pasigurinë, që po shoqërohej me largimin e banorëve nga shtëpitë, kundër çetave partizane vepruan dhe forcat e xhandarmërisë të instaluar në qytet.¹⁹

2 korrik 1943. Rrethimi i Përmetit shtrëngohet më tepër. Armikut iu ndalua furnizimi me ujë të pijshëm edhe nga burimi i qytetit. Dy ushtarë italianë, që ishin dërguar për të marrë ujë, ishin vrarë nga zjarri i mitrolozëve të forcave partizane, të cilat e kishin situatën nën kontroll.²⁰ Partizanët sulmonin gazermat në errësirë, dhe italianët, për t’i detyruar të pushonin sulmin, bombardonin periferinë e qytetit me anë të aviacionit, i cili hodhi dhe ndihma ushqimore për të vetët, një pjesë e të cilave binte në duart e partizanëve.²¹

Komanda e Shtabit të Operacionit të Zonës së Përmetit, ishte e interesuar për të garantuar mbështetjen e popullsisë vendëse. Ajo u nevojitej për të siguruar strehimin e partizanëve, furnizimin e tyre me ushqime dhe rritjen e numrit të forcave territoriale. Për këtë, i bëhej thirrje popullit të atij rrethi, për t’i dhënë fund vuajtjeve prej katër

¹⁷ *Po aty*, F. 149, V. 1943, D. III-839, fl. 173. Informacion i MPB, dërguar kryeministrit, ku thuhet se njoftimi është i bazuar në informacionin e marrë nga komanda e xhandarmërisë së Përmetit, datë 7 korrik 1943.

¹⁸ *Po aty*, f. 174. Shkresë e MPB, dërguar kryeministrit, sipas informacionit të marrë nga komanda e xhandarmërisë, qarku Gjirokastër, dt.8.7.1943.

¹⁹ *Po aty*.

²⁰ *AIH*, A-VIII-72, Buletin i Luftës ..., viti 1943, f. 34.

²¹ *Po aty*, f. 35.

vjetësh, nën thundrën e egër të pushtuesve.²² Ata u kujtonin përmetarëve, se një pjesë e forcave partizane, ishin duke marshuar në drejtim të Përmetit, Kuçarit e Këlcyrës dhe ishin të vendosur për të shfarosur armikun nga kjo krahinë, të gatshëm të derdhnin dhe pikën e fundit të gjakut. Në thirrjen e tyre thuhej, se përmetarët, si bijë të Naimit, Abdylit e Sami Frashërit, duhej të ishin të bashkuar dhe të bënin gjithçka për t'i dhënë goditjen përfundimtare pushtuesve.²³

Komandanti i garnizonit të Përmetit, Lesite Manfredo, kërkoi ndihmë urgjente në forca dhe municione për ushtarët e rrethuar. Ndërkohë, aviacioni italian kishte marrë urdhër të mitralonte nga lart forcat partizane dhe të furnizonte me ushqim garnizonin e Kuçarit. Italianët vazhduan me ngulm operacionin mbrojtës dhe paradite u vjen në ndihmë një autokolonë nga Tepelena, shoqëruar me armatime të rënda, e cila kaloi Dragotin dhe hyri në Grykën e Këlcyrës.²⁴ Aty u pritën me zjarr nga çeta “Hajredin Tremishti”, ardhur nga Kurveleshi dhe një pjesë e forcave të batalionit, që pas këtij operacioni, do të merrte emrin “Naim Frashëri”.

Si rezultat i përdorimit të artilerisë së rëndë dhe bombardimeve të pandërprera me aviacion, forcat partizane u detyruan të tërhiqeshin përkohësisht, për pasojë italianët që vinin nga Tepelena, në ndihmë të forcave të Kuçarit dhe të Përmetit, mundën të çanin rrethimin dhe të hynin në Këlcyrë, pa ndonjë rezistencë të dukshme nga forcat partizane. Madje, sipas një raporti të kryetarit të komunës së Këlcyrës, ata ishin pritur mirë, sidomos nga Muhamet Poli, “sekretar dhe kujdestar i pasurisë së Ali bej Këlcyrës”²⁵. Për këtë shkak, gjatë qëndrimit dhe lëvizjes së tyre në qendër të Këlcyrës dhe rrethina, italianët nuk kishin bërë asnjë dëm.²⁶

Në Qafën e Këçokut, krahas forcave partizane, në formacionet e luftimit, ishin përfshirë edhe 200 forca balliste nga Dëshnica, të kryesuar nga Hamid Xhunga, Karafil Zhepova, Refat Kaso, Vahip Beqiraj, Maliq Psari. Bënin pjesë dhe ato të Neim Shehut nga Tepelena, që drejtoheshin

²² AQSH, F. 67/APL, V. 1943, D. 5, fl.4/1. Thirrje e Komandës së Vendit Përmet, datë 2.07.1943, drejtuar popullit të krahinave të Dangëllisë, Ceries, Dëshnicës, Këlcyrës dhe Petranit.

²³ Po aty.

²⁴ Xh. Frashëri, *Lufta e armatosur ...*, f. 121.

²⁵ AQSH, F. 152, V. 1943, D. 96, fl. 1. Raport i Kryetarit të Komunës së Këlcyrës, Dhimosten Peti, datën 7.VII.1943, dërguar MPB.

²⁶ Po aty.

nga Baba Qamil Gllava.* Por, nuk mungonin dhe luftëtarë nga Skrapari, të komanduara nga Muharrem Kapllani.²⁷

Në ora 14 e 30, një autokolonë italiane kaloi Buzin dhe iu afrua Qafës së Kiqokut, kohë në të cilën, komandanti i shtabit operativ të sektorit, Zylyftar Veleshnja** kishte dhënë sinjalin e sulmit. Autokolona italiane u gozhdua në vend nga breshëria e të shtënave, ndaj ushtarët zbritën nga makinat dhe u përgjigjën me zjarr. Oficerët italianë shfrytëzuan një përrua, që nuk ishte nën mbrojtjen e partizanëve dhe tentuan të ngjiten drejt malit të Trebeshinës, për t'u marrë krahët kundërshtarëve, por u ndalën nga forcat vullnetare të fshatit Arrëz.

Komanda e Gjirokastrës informonte qendrën, se lufta vazhdoi disa orë dhe linja telefonike Përmet - Gjirokastrë ishte prerë. Ministria e Punëve të Brendshme ishte njoftuar se Përmeti dhe Këlcyra ishin në duar të çetave.²⁸ Thujse të njëjtën gjë raportonte dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në njoftimin e datës 7 korrik. Ajo pohonte, se mbasditen e vonë të 2 korrikut, në Kiqok të Përmetit, një çetë komuniste kishte sulmuar një autokolonë që vinte nga Berati në drejtim të Përmetit dhe konflikti kishte zgjatur deri në mëngjes. Informacionet, sipas tyre, ishin të shurdhëta, sepse Përmeti nuk përgjigjej, pasi ishin prerë linjat telefonike e telegrafike.²⁹

Armiku ishte detyruar të tërhiqet prapa dhe humbjet e tij në forca ishin të shumta, ndërsa nga radhët partizane, 6 të vrarë dhe 4 të plagosur.³⁰ Shifrat e të vrarëve nuk janë të qarta. Xhelal Staravecka, i cili ishte përqëndruar në luftimet e Kuqarit, kur mëson për situatën në Kiqok,

* Baba Qamil Gllava ishte baba i teqesë së Gllavës.

²⁷ *Përmeti gjatë luftës...*, f. 230.

** Zylyftar Veleshja - komandant i forcave të Skraparit.

²⁸ *AQSH*, F. 152/2, Pa vit, D. 113, fl.10. Njoftim zyrtar mbi lajmet e ditës nëpër prefektura dhe krahina, dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Tiranë. Dokumenti nuk ka datë.

²⁹ *Po aty*, F. 153, V. 1943, D. 224/2, fl. 89. Informacion i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, me firmën e zëvendës drejtorit Kolë Radovani, datë 7 korrik 1943, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

³⁰ *Po aty*. Sipas këtij informacioni, në Qafën e Kiqokut luftimet filluan në ora 2 e 30 të mëngjesit. Luftëtarët përballuan një autokolonë me 55 maqina, 3 autoblinda dhe shumë motoçikleta. Në luftimet që zgjatën 10 orë dhe arritën trup me trup, rezultoi të kishte shumë dëme. U dogjën 10 mjete, 5 maqina u kapën, 3 prej të cilave u vunë në përdorim prej forcave tona. Katër motoçikleta në gjendje të mirë u morën dhe u vunë në shërbim të luftës.

niset menjëherë për atje. Në kujtimet e tij, ai shkruante, se, “kur mbërrita, gjeta, përveç të plagosurve dhe 8 të vvarë”.³¹

3 korrik. Përpjekjet e italianëve për të çarë rrethimin në Qafën e Këlcyrës, vazhduan gjithë ditën. Sipas një lajmi zyrtar, aty ishin zhvilluar luftime të ashpra midis ushtrisë që kërkonte të merrte Këlcyrën dhe çetave partizane.³²

E njëjta situatë paraqitej dhe në Kuqar, ndonëse, më 3 korrik, pas luftimesh të ashpra, Këlcyra kishte rënë në duar të partizanëve.³³ Komanda italiane nuk pati asnjë mundësi për të dalë nga rrethimi, duke i mbajtur shpresat vetëm në një ndihmë të mundshme nga jashtë.

4 korrik. Në orët e para të mëngjesit, një autokolonë ushtarake kaloi Mezhgoranin dhe udhëtonte drejt Këlcyrës, por u prit me zjarr dhe luftimet vijuan rreth 8 orë. Drejtorja e Përgjithshme e Policisë, informonte Ministrinë, se kishte mbetur i vvarë komisar, Asim Zeneli.³⁴

Për shkak të vështirësive të krijuara në repartet e izoluara italiane, aviacioni mitralonte rajonin për rreth kazermave, ku mendohej se ishin pozicionuar partizanët, për t'i detyruar ata të tërhiqeshin, pasi forcat italiane ishin në pozita më të sigurta. Në një raport të atyre ditëve thuhej, se forcat italiane nuk kishin pasur asnjë dëm, “mbasi ishin të vendosura në llogore”.³⁵ Ndërsa, për forcat partizane, të cilat ata i quanin “ilegale”, thuhej, se kishin pësuar dëme të ndjeshme, pasi jo vetëm që ishin në ofensivë, por edhe të pa organizuara dhe të pa praktikuar në luftime.³⁶ Veç kësaj, forcat italiane, ishin të mbështetura edhe prej aviacionit, i cili ndihmonte ushtrinë për ta furnizuar nga ajri, por edhe për të paralizuar çetat partizane.³⁷ Mitralime u bënë në Kuqar e Përmet, madje dhe mbi

³¹ Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë ...*, f. 248.

³² *AQSH*, F. 153, V. 1943, D. 295, fl. 101. Telegram i komandës së xhandarmërisë, datë 4 korrik 1943, dërguar MP Brendshme.

³³ *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 96, fl. 35. Njoftim i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Tiranë, datë 4.7.1943, dërguar MPB.

³⁴ *Po aty*, F. 67/APL, V. 1943, D. 5, fl.12. Njoftim i Komandës së Vendit Përmet, datë 4.07.1943, dërguar Komandës së Operacionit të Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë.

³⁵ *Po aty*, f. 99.

³⁶ *Po aty*, F. 153, V. 1943, D. 295, fl. 99. Informacion i Komandës së Xhandarmërisë Përmet, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, datë 5 korrik 1943.

³⁷ *Po aty*, F. 149, V. 1943, D. III-839, fl. 173-174. Procesverbal i datës 7 korrik 1943, ditën e mërkurë, ora 10, mbajtur në zyrën e sekretarit të Komandës së

banesa të qytetarëve, duke detyruar qindra njerëz të braktisnin shtëpitë dhe të strehoheshin nëpër shpellat e maleve.

Garnizoni italian në Përmet vazhdonte të ndjente mungesën e ujit të pijshëm, ndonëse e zgjidhi atë pjesërisht nga çezmat e qytetit dhe furnizimet nga ajri. Nga njoftimet e komandave partizane, bëhej fjalë për sulme të organizuara të forcave shqiptare. Por, nga dokumentet e institucioneve zyrtare, rezultonte, që ato të kenë qenë sporadike, të natyrës së taktikës partizane, sulme guerile. Këtë e pohonte dhe një lajm i drejtorisë së policisë, i datës 4 korrik. Sipas këtij njoftimi, një çetë partizane, në ora 21 e 30 minuta, kishte sulmuar në afërsi të Përmetit dhe me ndërhyrjen e ushtrisë dhe xhandarmërisë, ishin larguar përsëri në drejtim të paditur.³⁸ Gjithsesi, efekti i tyre ishte shokues dhe si pasojë e këtyre goditjeve të befasishme, ushtarët nuk guxonin të dilnin për të marrë ushqime dhe sidomos për të mbushur ujë, në të vetmin burim, buzë Vjosës.

Komanda italiane e garnizonit, e revoltuar nga kjo gjendje, kishte thirrur kryetarin e bashkisë dhe i pati dhënë ultimatumin: “Në rast se nuk do të merreshin masa për ndalimin e sulmeve mbi komandë, ata do të shkatërrojnë gjithë qytetin”.³⁹

Pas këtij tensionimi të situatës, forcat partizane qëndruan disi të tërhequra dhe ushtarët italianë dolën në qytet, duke mundur të mbushin ujë lirisht në burim. Kjo tolerancë krijoi pakënaqësi në radhët e partizanëve. Komanda e Veprimit të krahut të majtë, do t’i shkruante komandës së shtabit të Operacionit të Zonës së Përmetit, më 5 korrik, se ajo tërheqje dhe lejimi i forcave italiane të dilnin në qytet, kishte krijuar një opinion të keq në popull, sidomos “lejimi i dërgimit të ndihmave në Kuqar dhe mbushja ujë e ushtarëve në Përmet”.⁴⁰

Komanda e operacionit thirri forca të tjera në ndihmë të partizanëve, të cilat dubluan rrethimin e garnizonit të Përmetit, me mendimin, se me shtimin e rrathëve të rrethimit, “bllokimi i forcave

Xhandarmërisë Përmet, mbi ngjarjen e datës 6 korrik, firmosur nga sekretari nënprefekturës Xhaferr Mehmet, dërguar prefekturës Gjirokastër dhe kjo MPB.

³⁸ *Po aty*, F. 153, V. 1943, D. 224/2, fl. 85. Informacion i DP Policisë, në të rejat e mëngjesit, të datës 4.7.1943.

³⁹ *Po aty*, F. 67/APL, V. 1943, D. 5, fl.15. Komanda e Vendit në Përmet, njoftim për Komandën e Operacionit, datë 4 korrik 1943.

⁴⁰ *Po aty*, fl.17.

italiane do të jetë më efektiv”.⁴¹ Partizanët ishin të bindur se, po të këmbëngulej në mbajtjen e tyre të rrethuar, dhe sidomos duke siguruar anën e lumit dhe ndaluar mbushjen e ujit në burim, kishte shumë mundësi që italianët të dorëzoheshin pa kushte.⁴² Për të shmangur qëndrimin e lëkundur të disa anëtarëve të shtabit të operacionit, shtoheshin informacionet mbi dëmet e armikut dhe nevojën e një sulmi më të ashpër mbi ta, pasi italianët e kishin dhënë sinjalin e keq, duke djegur në qytet 4 dyqane, si dhe në fshatrat Leusë e Leshicë, tri shtëpi.⁴³

Po në datën 4 korrik 1943, niset një tjetër autokolonë ushtarake nga Berati, me 40 makina, për t’u ardhur në ndihmë forcave, që u bllokuan nga partizanët një natë më parë, në Lajthizë.* Pasi u bashkuan me forcat e dëmtuara, autokolona tentoi sërish të vijonte rrugën drejt Përmetit, por u godit nga forcat partizane në të dalë të fshatit Lajthizë.⁴⁴

5 korrik. Në orët e para të mëngjesit, ushtria italiane kishte çarë rrethimin dhe ishte bashkuar me forcat e tjera të Lajthizës. Pas kësaj, ajo marshoi drejt Këlcyrës.⁴⁵ Duke qenë të mbështetur me tanke, italianët zbatuan taktikën e mësymjes. Forcat partizane, të bindura se përparimi i regjimentit nuk mund të ndalej, u detyruan të tërhiqen “duke marrë me vete 4 shokët e tyre të vranë”.⁴⁶ Ato u tërhoqën fillimisht për në katundin Bubës dhe pas kësaj u shtrinë në Vinokash, Kajcë e Pavar.⁴⁷

Një tjetër fuqi që vinte nga Tepelena, mundi të kalonte për në Këlcyrë. Për Xhelal Staraveckën, çetat partizane u detyruan të tërhiqeshin, pasi ishin vendosur midis dy zjarresh, fuqisë fashiste dhe presionit ballist**, gjë që u krijoi mundësinë italianëve të hynin në Këlcyrë.⁴⁸

⁴¹ *Po aty.*

⁴² *Po aty.*

⁴³ *Po aty.*

* Lajthiza, fshat në rrugën Kiçok-Berat, 2 km matanë Qafës së Kiçokut.

⁴⁴ *AQSH*, F. 67/APL, V. 1943, D. 5, fl.5. Raport i Komandës së Vendit Përmet, për Komandën e Operacionit, datë 4 korrik 1943.

⁴⁵ *Po aty.*

⁴⁶ *Përmeti gjatë luftës...*, f. 235.

⁴⁷ *AQSH*, F. 67/APL, V. 1943, D. 5, fl.6. Komanda e Vendit në Përmet, njoftim për Komandën e Operacionit, datë 4 korrik 1943.

** Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë...*, f. 250. Sipas tij, komanda e Ballit u kishte thënë të largoheshin, sepse nuk donin shkatërrimin e vendit nga reprezaljet e italianëve. Dhe, sipas Staraveckës, kjo kishte ndodhur, kur kishin tri

Autokolona ushtarake italiane, në orët e para të pasdites së 5 korrikut, hynë në Këlcyrë dhe i vunë zjarrin qytetit, ndërsa në mëngjesin e datës 6, shkuan në ndihmë të garnizonit italian të Përmetit. Me të mbërritur, ajo filloi sulmin kundër çetave partizane, të cilët “të friksuem prej fuqisë ushtarake, qysh në minutat e para u shpartalluan dhe u larguan në drejtime të ndryshme”⁴⁹. M.P.Brendshme njoftonte Kryeministrinë, se Komanda e Garnizonit Ushtarak të Përmetit, për ta bërë shembull, që të mos ndodhnin më gjëra të tilla në vende të tjera, “ka dhënë urdhër të digjet Përmeti”.⁵⁰ Sipas Xh. Staraveckës, ishte epërsia e ushtrisë italiane ajo, që detyroi çetat partizane të tërhiqeshin dhe okupatori hyri në qytetet Këlcyrë dhe Përmet duke i djegur ata”.⁵¹

Djedia e qyteteve Këlcyrë dhe Përmet

Ushtria italiane, e indinjuar nga humbjet e rënda që pësoi në luftimet e zhvilluara në Këlcyrë, Kuqar e Përmet, sapo zbriti në krahinën e Dëshnicës, në orët e para të pasdites së datës 5 korrik, dogji dy fshatrat e parë që hasi në rrugë; Ballabanin dhe Sukën.⁵² Ndërsa, një orë më pas, ato kishin hyrë në Këlcyrë dhe u kishin vënë zjarrin gjithë godinave të pazarit, banesave dhe mjediseve tregtare, si dhe zyrave të Komunës dhe të Postë Telegrafës.⁵³ Ndonëse tregtarët e kishin hequr mallin, që në fillim të luftimeve, dëmet e shkaktuara nga djedia e godinave kanë qenë të rënda. Në zyrat e komunës, përveç godinës, ishin djegur edhe mobiljet, aktmarrëveshjet e ndryshme dhe regjistrat kadastralë. Kishin shpëtuar

ditë që luftonim. Çetat e Ballit, “nuk u çuan kundra nesh sapo filloi aksioni, por më vonë, kur morën urdhër”.

⁴⁸ Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë...*, f. 250.

⁴⁹ *AQSH*, F. 149, V. 1943, D. III-839, fl. 173-174. Shkresë e MPB dërguar kryeministrisë, sipas informacionit të marrë nga komanda e xhandarmërisë, qarku Gjirokastër. Procesverbal i datës 7 korrik 1943, mbajtur në zyrën e sekretarit të Komandës së Xhandarmërisë Përmet, mbi ngjarjen e datës 6 korrik, firmosur nga sekretari nënprefekturës Xhaferr Mehmet, dërguar prefekturës Gjirokastër.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë...*, f. 250.

⁵² *Po aty*, f. 236.

⁵³ *AQSH*, F. 152, V. 1943, D. 96, fl. 1. Shkresë e kryetarit të komunës Këlcyrë, Dhimosten Peti, Nr. Extra, dt. 13.07.1943, dërguar prefekturës Gjirokastër. Prefektura e nis në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Prot. Nr. 51/131, dt. 15.7.1943.

regjistrat e kontabilitetit, ato të protokollit të akteve rezervate me një pjesë tjetër dokumentesh, të cilat ishin marrë më parë, nga sekretari i komunës, Azis Elmazi, për t'u ruajtur në shtëpinë e tij, në katundin Këlcyrë".⁵⁴ Në raportin që i dërgonte kryetari i zyrës së PTT Këlcyrë, Drejtorisë së Përgjithshme në Tiranë, thuhej se në ora 16.⁴⁰ të datës 5 korrik, ushtria italiane kishte djegur krejt lokalitetin e PTT, Këlcyrë, pa shpëtuar asgjë, ndonëse personeli pati mundur të dilte jashtë zbatshur.⁵⁵

Pas djegies së Këlcyrës, ushtria vazhdoi rrugën, dhe në fshatin Grabovë, u vunë zjarrin të gjitha shtëpive, që ndodheshin në afërsi të Kuqarit. Lidhur me shkaqet e djegies së Këlcyrës, në një dokument të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dërguar Kryeministrisë, shpjegohet, se arsyeja e këtij akti makabër, ishin luftimet në Kuqar.⁵⁶

Marshimi i italianëve vijoi në drejtim të Përmetit, duke mos lënë godinë pa djegur e shkatërruar. U shkrumbua krejt tregu i përbërë nga 77 dyqane, si dhe 125 shtëpi të lagjes Varosh, duke përfshirë dhe 10 zyra shtetërore, me gjithçka kishin brenda: u dogjën nënprefektura, Gjyqi i Paqit, zyra e Financës, bashkia, komuna Qendër, zyra e Veterinarisë, zyra e Bujqësisë, ajo e Punëve Botore, drejtorja Post-Telegrafe, zyra e Fashit, etj.⁵⁷

Me djegien e shtëpive dhe të dyqaneve u dëmtua dhe gjithë malli i tregtarëve, pasuria e tundshme shtëpiake dhe deri te veshmbathjet e familjeve.⁵⁸ Dëmet e shkaktuara nga djegia e Përmetit dhe Këlcyrës, ishin aq të mëdha, sa prefektura e Gjirokastrës shprehej, se nuk mund të çmoheshin prej tyre.⁵⁹ Por zjarri më i madh ra mbi shtëpitë e bukura dhe dyqanet e lagjes Varosh, duke shkretuar ato dhe kthyer në gjendje zije.

⁵⁴ *Po aty.*

⁵⁵ *Po aty*, F. 187, V. 1943, D. 41, fl. 17. Raport i kryetarit të Zyrës së PTT Këlcyrë, i shkruan Drejtorisë së Përgjithshme të PTT, Tiranë, datë 11. 07.1943.

⁵⁶ *Po aty*, F. 149, V. 1943, D. III-839, fl. 174. Shkresë e MPB dërguar kryeministrisë, sipas informacionit të marrë nga komanda e xhandarmërisë, qarku Gjirokastrë, datë 8.7.1943. Procesverbal i datës 7 korrik 1943, ditën e mërkurë, ora 10, mbajtur në zyrën e sekretarit të Komandës së Xhandarmërisë Përmet, mbi ngjarjen e datës 6 korrik, firmosur nga sekretari i nënprefekturës Xhaferr Mehmet, dërguar prefekturës Gjirokastrë.

⁵⁷ *Po aty.*

⁵⁸ *Po aty.*

⁵⁹ *Po aty.*

Djegia ishte një tragjedi e vërtetë, që pikëlloi zemrat e banorëve dhe mjeri më tepër jetën e tyre të varfër. Njerëzit ishin larguar nëpër male, vetëm me rrobat e trupit. U mungonin ushqimet më të domosdoshme dhe racionohej gjithçka. Ndihma nga fshatrat ishte e vështirë, sepse shumë prej tyre ishin djegur. Edhe ato fshatra, që patën fatin të mos përpihen nga flakët, ishin varfëruar së tepërmi, sepse gjatë tre javëve kishin mbajtur me ushqim mbi 1500 forca partizane, të grumbulluara ditë më parë, për organizimin e këtij operacioni.⁶⁰

Burra, gra, pleq e fëmijë, gjithë popullsia përmetare e strehuar në guvat e malit Dhëmbel, shihnin flakët e zjarreve, që përpinin shtëpitë dhe pasurinë e tyre dhe psherëtinin me dhimbje të thellë e indinjatë. Por, më tronditëse se këto pamje, ishte humbja e jetëve njerëzore. Që ditën e parë të këtij operacioni, ushtarët ekzekutuan dhe plagosën nga radhët e popullsisë civile një numër personash, midis të cilëve; Stavro Paskali, Muftar Baçi, Gjenica Zallari, Stiri Izgari. Evgjenia Kukureci, Polikseni Petro, Sotir Palluqi, Erefili Lamani, etj.⁶¹ Staravecka, përmend kapitenin anglez David,* i cili, duke parë dëshpërimin e luftëtarëve, që shihnin flakët mbi Përmet nga Lupcka, këshillonte të mos hidhëroheshin, sepse ata që po digjnin qytetin e Përmetit, në një moment tjetër, do të paguanin shumë më tepër se ato dëme.⁶²

Bashkia e Përmetit, në një raport të saj, dërguar Zyrës Politike në MPB, pohonte, se ishin djegur 177 tregtore, shumica e të cilave ndërtime moderne.⁶³ Zjarri ishte vënë mbi shtëpitë më të mira, në të cilat ishte strehuar gjysma e popullsisë së Përmetit.⁶⁴ Flakët kishin përrpirë 126 godina të reja të ndërtuara në ato vite, gjithë zyrat qeveritare, si dhe bashkia, “simbolike në prezencë”.⁶⁵ Nga hetimet e zhvilluara rreth

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *Po aty*, F. 294, V. 1943, D. 816, fl. 4. Telegram i prefekturës Gjirokastrë dërguar ministrisë së Punëve të Brendshme Tiranë, datë 7 korrik 1943.

* Duhet të jetë fjala për kapitenin anglez David Smajl.

⁶² Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë ...*, f. 251.

⁶³ *AQSH*, F. 152, V. 1943, D. 95, fl. 11. Raport i bashkisë së Përmetit, datë 26 korrik 1943, dërguar Zyrës Politike në MPB.

⁶⁴ *Përmeti gjatë luftës...*, f. 237.

⁶⁵ *Po aty*, f. 11. Shkresë e bashkisë së Përmetit, dt. 7.07.1943, dërguar Zyrës Politike në MPB, në datë 26 korrik 1943.

djegies së tyre, rezultonte të ishin zhdukur krejt dokumentet e Kadastrës, hipotekës e bashkisë regjistrat e kadastrës, hipotekës e bashkisë.⁶⁶

Lidhur me gjendjen e financave në Bashki dhe Komunë, nënprefektura nuk kishte mundur të merrte informacionin e duhur, prandaj për verifikimin e saktë të gjendjes së tyre, e shihte të domosdoshme, “dërgimin e një inspektori të posaçëm”.⁶⁷ E njëjta gjendje ishte edhe në komunat Këlcyrë dhe Ballaban, nëpunësit e të cilave ishin larguar dhe nuk ishin kthyer ende, pasi mungonin ndërtesat ku duhej të strehoheshin dhe punonin. Italianët kishin thyer dyert e zyrave të institucioneve shtetërore, duke marrë të hollat që gjendeshin në arka. Kasafortat e zyrës së financës, bashkisë dhe komunës Qendër, ishin copëtuar me forcë prej ushtarëve të operacionit.⁶⁸ Më 13 korrik, zv/nënprefekti Xhaferr Mehmeti, i shkruante prefekturës Gjirokastrë, se në qytetin e Përmetit, ishin djegur të gjitha zyrat shtetërore dhe ato parashtetërore.⁶⁹

Zyrtarët e nënprefekturës e shihnin situatën të zyrtë. Sipas tyre, rikonstruksioni i zyrave shtetërore ishte krejtësisht i pamundur, pasi, jo vetëm që nuk gjendeshin lokale, por nuk kishte asnjë karrike, tryezë apo letër e bojë për të shkruar, pasi mungonin dhe tregjet.⁷⁰

Numri i madh i shtëpive të djegura dhe stina në të cilën ndodhi ngjarja, i shtonte më tej vështirësitë për bashkinë e Përmetit. Ajo ishte alarmuar, pasi nuk ishte në gjendje t’u jepte rrugë problemeve. Popullsia e mbetur pa strehë, ishte bashkuar në godina ordinere të padjegura.⁷¹ Mbipopullimi i banesave të mbetura kishte krijuar shqetësim, sepse, në një godinë me 3 apo 4 të ndara, jetonin tri-katër familje, “me frymë të konsiderueshme”.⁷² Duke përshkruar gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej popullsia, bashkia kërkonte të merreshin masa të domosdoshme

⁶⁶ *Po aty.*

⁶⁷ *Po aty.*

⁶⁸ *Po aty*, F. 294, V. 1943, D. 816, fl.4. Telegram i prefekturës Gjirokastrë dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme Tiranë, datë 7 korrik 1943.

⁶⁹ *Po aty.*

⁷⁰ *Po aty*, fl.5.

⁷¹ *Po aty.*

⁷² *Po aty.*

mbrojtjeje, për të mos u shfaqur sëmundje epidemike, të cilat mund të sillnin katastrofë për popullsinë.⁷³

Situata, mbi të ardhmen shëndetësore të popullsisë së pastrehë, bëhej më kaotike edhe për shkak se mungonte personeli mjekësor. Mjeku i qendrës shëndetësore Përmet, kishte qenë larguar me leje dy muaj më parë dhe nuk ishte kthyer. Zyrtarët lokalë i kërkonin Ministrisë së Punëve të Brendshme të ndërhynte pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë, që të dërgonin një mjek, sa më shpejt të ishte e mundur.⁷⁴ Ministria u vu në lëvizje dhe porosiste D.P. të Shëndetësisë, të vepronte menjëherë, për t'u ardhur në ndihmë njerëzve, me qëllim që të shmangej rreziku i ndonjë epidemie në popullin e qytetit.⁷⁵

Puna në administratë ishte pezulluar krejtësisht. Rendi mungonte, pasi me hyrjen e çetave partizane dhe presionin e ushtruar prej tyre, më 1 korrik, qyteti i Këlcyrës ndihej i zbrazur. Ishin larguar, jo vetëm tregtarët, por dhe personeli i komunës. Me përjashtim të policit Izet Duraj, nga Buzi i Tepelenës, gjithë nëpunësit e tjerë të administratës, që ishin punësuar nga fshatrat e krahinës, ndodheshin pranë familjeve të tyre.⁷⁶

Dhënia e ndihmave për të dëmtuarit shihej shumë e vështirë. Informacionet thoshin, se ndihma urgjente nuk mund të vinin, në një kohë që popullsia ndodhej në gjendje mizerje.⁷⁷ Bashkia e Përmetit, nuk kishte llogari të saktë për dëmet, ndonëse mendonte, se shifra kalonte mbi 2 milionë fr.ari. Më 26 korrik, ajo i shkruante Ministrisë së Punëve të Brendshme Tiranë, se krahas mallit të tregtarëve, ishin djegur gjithë pasuria e tundshme e familjeve, popullsia e të cilave ishte larguar për t'u mbrojtur nga bombardimet ajrore.⁷⁸

⁷³ *Po aty*, F. 152/2, V. 1943, D. 95, fl. 11. Shkresë e bashkisë Përmet, dërguar Zyrës Politike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, dt. 26.7.1943.

⁷⁴ *Po aty*.

⁷⁵ *Po aty*, fl. 12.

⁷⁶ *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 96, fl. 1. Shkresë e kryetarit të komunës Këlcyrë, Dhimosten Peti, Nr. Extra, dt. 13.07.1943, dërguar prefekturës Gjirokastër. Prefektura e nis në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Prot. Nr. 51/131, dt. 15.7.1943.

⁷⁷ *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 95, fl. 11.

⁷⁸ *Po aty*, F. 149, V. 1943, D. III-839, fl. 174. Shkresë e MPB dërguar kryeministrisë, sipas informacionit të marrë nga komanda e xhandarmërisë, qarku Gjirokastër, datë 8.07.1943. Shkresa bazohej ne procesverbalin e datës 7 korrik 1943, ditën e mërkurë, ora 10, mbajtur në zyrën e sekretarit të Komandës së

Për shkak të kësaj katastrofe, familjet e mbetura pa strehë, të frikësuar mos i vrisnin apo internonin, ishin larguar me rrobat që kishin veshur dhe fëmijët e mitur në krahë. Një pjesë ishin ngjitur malit, të tjerë kishin shkuar nëpër katunde të largëta, shumica e të cilëve ende nuk ishin kthyer.⁷⁹ Populli kishte mbetur pa ushqim, edhe për faktin, se krahas ndërtesave të tjera, u dogjën edhe magazinat e drithit.

Në një raport të çetës “Musa Fratari”, për qarkorin Gjirokastër, korrik 1943, thuhej, se kishin mbetur pa strehë dhe pa bukë, rreth 3 mijë frymë.⁸⁰ Pas qetësimit të situatës, u shkruan një sërë raportesh nga zyra të ndryshme të pushtetit lokal. Kryetari i Komunës Qendër, në Përmet, Kristo Qamo, më 20 korrik deklaronte, se gjatë djegies së pjesës më të madhe të qytetit të Përmetit, ishte djegur dhe zyra e asaj komune, me gjithë regjistrat dhe shtypshkrimet e ndryshme, dokumente, mobilje, vula, etj.⁸¹

Askush nuk e dinte, nëse forcat italiane kishin qëllim të ngjiteshin drejt krahinës së Zagories. Sipas një njoftimi të këshillit të rrethit dhe komandës së vendit, po merreshin masa për të mobilizuar popullin.⁸² Në një letër, të datës 12 korrik, dërguar komandës së operacionit të zonës së Përmetit, Kaçiatori* bënte me dije, se kishte ardhur Dushani.** Ai thoshte, se pati qëndruar gjatë në atë zonë, për shkak të punëve të luftës, por ajo që i kishte tërhequr më shumë vëmendjen, kishte të bënte me faktin, se me djegien e Përmetit, popullsia ishte ftohur shumë.⁸³ Për pasojë, njësitet guerile të Rrëzës, Mezhgoranit, Damësit etj., duhej të

Xhandarmërisë Përmet, mbi ngjarjen e datës 6 korrik, dërguar Ministrisë nga komanda e xhandarmërisë së qarkut Gjirokastër.

⁷⁹ *Po aty*, F. 294, V. 1943, D. 816, fl.4. Raport i Bashkisë së Përmetit, datë 26 korrik 1943, dërguar Zyrës Politike në MPB.

⁸⁰ *Po aty*, fl. 239.

⁸¹ *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 470, fl. 34. Shkresë e kryetarit të komunës Qendër Përmet, Kristo Qamo. Deklaratë mbi djegien e zyrave të komunës Qendër, datë 6 korrik 1943.

⁸² *Po aty*, F. 67/APL, V. 1943, D. 5, fl. 27. Telegram Komandës së Shtabit të Operacionit, datë 10.7.1943 nga Kaciatori.

* Pseudonim i Bedri Spahiut.

** Dushan Mugosha, i deleguar i PK Jugosllave.

⁸³ *Po aty*, F. 67/APL, V. 1943, D. 5, fl. 29. Raport i Komandës së Vendit Përmet për Komandën e Operacionit të Zonës Parë Operative Vlorë-Gjirokastër, datë 12 korrik 1943.

largoheshin nga ana veriore e Grykës së Këlcyrës. Sipas këtij informacioni, edhe çetat e asaj ane, nuk ndiheshin më të sigurta, ndaj u tërhoqën dhe u mblodhën në anën e Peshtanit.⁸⁴

Ftohja e popullsisë në raport me forcat partizane, lidhej me nxitimin e aksionit antifashist. Tërheqja e forcave partizane, sipas parimit të luftës guerile, krijoi vështirësi të mëdha për popullsinë vendase, e cila mbeti e zbuluar përpara barbarisë armike. Italianët, kaluan mbi Mezhgoran dhe zunë pozitat që kishin në fillim partizanët. Kjo bëri, që ata të kishin mundësi të hynin pa vështirësi në Peshtan dhe të bëheshin zotër të atyre anëve.⁸⁵

Djegia e Përmetit, Këlcyrës dhe disa fshatrave, padyshim tregon natyrën e egër të pushtuesit ndaj popullsisë civile shqiptare. Përmeti u ndez nga flakët për orë dhe ditë të tëra, ku qindra shtëpi u shkrumbuan. Një pjesë e njerëzve, që mbeti në banesa, nuk u pa më, pas rikthimit të banorëve në qytet. Sidoqoftë, të tjerë u gjetën nën rrënojat e banesave të tyre, të shtrirë në tokë nga plagët e plumbave ose të djegur nga flakët e zjarreve. Nuk janë evidentuar as vdekjet e ndodhura në shpella, të pleqve dhe fëmijëve, diku për shkak të rrëzimeve nga ikja me ngut dhe herë të tjera nga sëmundjet akute apo kronike, të cilat ishte e vështirë të kuroheshin në shpella. Atëherë, askush nuk kishte kohë të merrej me ta. Nëse, më 5 korrik 1943, ky qytet kishte mbi 950 shtëpi, çlirimi e gjeti vetëm me 40 shtëpi, në të cilat jetonte popullsia e mbetur e qytetit.⁸⁶ Në vitin e parë të lirisë, Përmeti të kallte frikën me praninë e shtëpive-gërmadha, me mure të lartë dhe të frikshëm, gati për t'u rrëzuar. Vetëm më 30 mars të vitit 1945, pushteti vendor dha leje për ndërtimin e disa dyqaneve në treg dhe u soll një grup gjeometrish për të mundësuar rilevimin e qytetit të djegur, për t'u bërë studimet e nevojshme, me shpresë rindërtimin e tij.⁸⁷

⁸⁴ *Po aty*.

⁸⁵ *Po aty*, f. 30.

⁸⁶ Alqi Kristo, "Një sy mbi Përmetin e zhuritur", në: *Bashkimi*, nr. 46, Tiranë, dt. 25 shkurt 1945, f.3.

⁸⁷ *Po aty*.

Komision në ndihmë të familjeve pa strehë

Nënprefektura e Përmetit, menjëherë pas ngjarjes, mori masat që vareshin prej saj, për të shmangur vdekjen e njerëzve nga uria. Ajo ngriti një komision, që do të merrej me studimin e gjendjes dhe shpërndarjen e ushqimeve, veshjeve dhe nevojat për të pastrehët. Për këtë çështje, më 13 korrik, nënprefektura sqaronte, se deri atë ditë, nga ana e qeverisë Mbretnore, ishin dërguar 40 kv misër falas, “i cili iu shpërnda të mjerumve menjëherë”.⁸⁸ Po ashtu, ndihma kishin ardhur dhe nga Porto Edda*, në shumën “84 kv miell gruni me të holla”.⁸⁹ Por, sasia e tyre ishte e papërfillshme, pasi numri i familjeve, që ishin larguar nga Përmeti, për në vende të ndryshme të Mbretnisë dhe që mund të siguronin përkrahje apo strehë, bazuar në të ardhurat e tyre, qenë të pakta.⁹⁰

Në rrethanat që ndodhej popullsia, nënprefektura e Përmetit e shihte mjaft të vështirë situatën, ndaj i lutej prefekturës Gjirokastrë, të bënte përpjekjet e duhura, për të kërkuar në mënyrë urgjente një ndihmë të konsiderueshme, pa të cilën jetesa e tyre ishte e pamundur.⁹¹ Të njëjtin shqetësim, për vështirësitë e krijuara, shprehte edhe bashkia e Përmetit. Sipas saj, kishte ngadalësi në marrjen e masave për t’u ardhur në ndihmë “pjesës më të uritur” të popullsisë. Sigurimi i burimeve ushqimore brenda rrethit, ishte e pamundur, për shkak se prodhimi ushqimor ishte djegur edhe në disa fshatra të këtij rrethi.⁹² Për të dalë nga kjo gjendje, ata kërkonin t’u dërgohej një sasi bereqeti, pasi dhe mullinjtë kishin vështirësi për t’u venë në punë, për shkak të mungesës së ujit dhe problemeve të tjera.⁹³ Për të realizuar në kohë dhënien e ndihmave për popullsinë e Përmetit, dilte e nevojshme “të çelej një fushatë ndihme me urgjencë”.⁹⁴

⁸⁸AQSH, F. 294, V. 1943, D. 816, fl.5. Shkresë e nënprefektit, Xhaferr Mehmeti, dërguar prefekturës Gjirokastrë, datë 13 korrik 1943.

* Saranda.

⁸⁹ *Po aty.*

⁹⁰ *Po aty.*

⁹¹ *Po aty.*

⁹² *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 95, fl. 11. Shkresë e bashkisë Përmet, dt. 26.07.1943, dërguar Zyrës Politike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Tiranë.

⁹³ *Po aty.*

⁹⁴ *Po aty.*

Zgjidhja e problemeve që shtroheshin, nuk mund të arrihej pa praninë e zyrave, si mjedise të punës, ku duhej të qëndronin nëpunësit për t'u marrë me shqetësimet e popullsisë. Për hapjen e tyre, zyrtarët e bashkisë kërkonin autorizimin e ministrisë së P. Brendshme, për të siguruar “ndonjë lokal dokudo”.⁹⁵ Kjo masë ishte e nevojshme të shpejtohej, pasi edhe situata e punonjësve, ishte në gjendje të keqe, si në aspektin e strehimit dhe të ushqimit. Për të stabilizuar gjendjen e tyre dhe mundësinë e realizimit të detyrës, bashkia i kërkonte Ministrisë, t'i dërgonte një ndihmë financiare prej 8000 fra.shq.⁹⁶ Kjo nevojë emergjente justifikohet, sepse me djegien e tregut dhe të disa fshatrave, nuk ishte e mundur të garantohej vjelja e taksës së bashkisë.⁹⁷ Zyrtarët siguronin Ministrinë, se po të akordohej një ndihmë e tillë, mund të kalohej pragu i vështirësive emergjente për punonjësit dhe mund të siguroheshin mjetet e domosdoshme zyrtare, pasi, “po veprojmë në rruga, në vende publike, si kafene e tjera”.⁹⁸

Mbas djegies së tregut të Përmetit dhe zyrave të bashkisë, personeli mbeti, jo vetëm pa banesë por edhe pa rroga. Prandaj, nga institucioni i pushtetit vendor, i kërkohej Ministrisë të dërgonte sa më parë një shumë prej 6000 fra. shq. nga fondi i subvencioneve.⁹⁹

Rreth pikëpamjeve mbi ngjarjen

Pas përfundimit tragjik të aksionit partizan, u ndez një debat i ashpër midis forcave politike të kohës. Qysh në fillim, përfaqësuesit e Frontit NAÇL, pohonin, se aksioni ishte i justifikuar. Sipas tyre, forcat partizane u bënë ballë të gjitha sulmeve italiane, në të katër pikat kyçe, në Grykën e Këlcyrës, Qafën e Kiçokut, Kuqar e Përmet. Ata argumentonin me këmbëngulje, se po të vazhdonte rrethimi edhe 48 orë të tjera, fortifikata e Kuqarit dhe ajo e Përmetit, do të ishin dorëzuar. Kjo bazohej në faktin, se ndihmat e aviacionit për ushtarët e ngjuar në bunkerë po shteronin gradualisht, pasi ato binin në duar të forcave partizane.¹⁰⁰

⁹⁵ *Po aty.*

⁹⁶ *Po aty.*

⁹⁷ *Po aty.*

⁹⁸ *Po aty.*

⁹⁹ *Po aty*, F. 152/2, V. 1943, D. 95, fl. 13. Shkresë e Kryetarit të Zyrës Politike në MPB, me Nr. 179/I, dt. 3.8.1943, dërguar Drejtorisë së Bashkive dhe Komunave në këtë Ministri.

¹⁰⁰ Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë ...*, f. 249.

Ndërsa për shtabin operativ të atij operacioni, sulmi i organizuar nuk doli me sukses, pasi forcat italiane u sulmuan pa e njohur mirë gjendjen. Në Kuqar, sulmi u bë pa u garantuar pritja, pa njohje të mirë të terrenit, por dhe për gabime të tjera nga shtabet e forcave partizane, që morën pjesë në këto sulme¹⁰¹.

Krerët lokalë të Ballit, si Veli Zleusha dhe ata të krahinës së Dëshnicës, e kundërshtuan sulmin. Ata këshillonin të mos nxitoheshin, se italianët ishin ende të organizuar mirë dhe forcat shqiptare nuk ishin në gjendje për t'i asgjësuar ato. Por ky mendim nuk u mor në konsideratë nga partizanët. Kur panë këmbënguljen e vazhdueshme të tyre, për të vazhduar me çdo kusht goditjen e forcave italiane, ballistët u shprehën të alarmuar. Me veprime të tilla, partizanët po bëheshin shkak për të djegur e shkatërruar qytete e fshatra. Sipas tyre, sapo komunistët të fillonin sulmin, “italianët do të na çkulin me kuç e me maç”.¹⁰²

Gjithsesi, partizanët nuk u tërhoqën nga plani i hartuar më parë dhe i ftuan ballistët të luftonin bashkë me ta. Pas kësaj, forcat balliste u ndanë në dy grupe. Njëri grup me Veli Zleushën, njoftoi se do të merrte pjesë në sektorin e Kuqarit. Hamid Xhunga, Karafil Zhepova, Maliq Psari dhe Naim Shehu, morën rrugën për në Qafën e Këçokut. Ndërsa grupi tjetër ndoqi këshillat e Ali Këlcyrës, Baba Kamberit* dhe Abaz Ermenjit, të cilët deklaruan, se nuk do të merrnin pjesë në atë operacion, pasi kishte rrezik të acarohesh situata dhe të digjej krahina.¹⁰³

Të bindur se raporti i forcave ishte në dëm të shqiptarëve, ditën e tretë të luftës, në një mbledhje që u organizua në Buz, krerët e Ballit kërkuan të ndalohej sulmi. Ata mendonin, se në ato rrethana, nuk duhej të kryheshin veprime të armatosura kundër ushtrisë italiane, duke nxjerrë si arsye kryesore, raportin jo të favorshëm të forcave dhe “frikën e djegies së fshatrave”.¹⁰⁴

Në fakt, ideja e ndaljes së sulmit, për të shmangur djegien e vendbanimeve, ishte kudo. Xhelal Staravecka pohonte, se Bektash

¹⁰¹ *AQSH*, F.20/APL, V. 1943, D.10, fl.7.

¹⁰² *Përmeti gjatë luftës nacionalçlirimtare ...*, f. 223.

* Baba Kamberi ishte baba në teqen e Sukës dhe të Prishtës. Për pasojë, kishte influencë të madhe në krahinën e Dëshnicës.

¹⁰³ *Po aty*, f. 224.

¹⁰⁴ *Po aty*.

Cakrani, i kishte thënë me gojën e tij*, në oborin e shtëpisë së vet, se me veprimet e pastudiuara që po kryenin partizanët, Mallakastra rrezikonte të digjej.¹⁰⁵ Dhe Mallakastra vërtet u dogj.

Një pikë tjetër mospajtimi midis këtyre dy forcave politike, ishte edhe qëndrimi ndaj organeve shtetërore të kohës, veçanërisht atyre të rendit. Nacionalistët ishin për luftë, por njëkohësisht kërkonin të ruheshin strukturat e rendit, pasi ato mbanin rregullin e qetësinë e qytetit apo krahinës. Në këtë mënyrë, familjet do të ishin më të sigurta në banesat e veta dhe burrat do të ndiheshin më të qetë dhe të motivuar në luftë kundër pushtuesit. Ndërsa, komunistët nuk bënë ndarje midis pushtuesit dhe pushtetit lokal të kohës. Në strategjinë e tyre, ata kishin luftën kundër administratës shtetërore lokale, largimin e saj dhe marrjen e komandës xhandarmërisë. Pra, motoja e tyre ishte rrëzimi i strukturave të shtetit dhe kontrollin e tyre nëpërmjet këshillave nacionalçlirimtare dhe komandës së vendit. Ndaj propagandonin për të mos i dhënë qeverisë “asnjë xhandar dhe asnjë ushtar”.¹⁰⁶

Kjo strategji, jo rrallë herë pati çmim të lartë për popullsinë. Por, nga ana tjetër, duhet thënë, që forcat e xhandarmërisë, si struktura të një qeverie kukull, kanë luftuar dhe kundër çetave partizane, nën motivin e ruajtjes së rendit, duke qenë në këtë mënyrë, mbështetje për forcat italiane. Kjo provohet me një dokument të komandës së xhandarmërisë, ku thuhet, se luftimet kishin vazhduar për 5 ditë rresht. Në favor të ushtrisë italiane, sulme kundër çetave komuniste, me qëllim vendosjen e rendit dhe shmangien e ikjes së qytetarëve nga shtëpitë e tyre, kishte kryer dhe “fuqia e gjindarmërisë Mbretnore, e përbame prej 50-55 vetash”. Ajo ndodhej e instaluar në kazermet e saj, në qytet dhe komandohej nga oficeri, Rexhep Beqiri.¹⁰⁷

Gjithsesi, pushteti lokal në Përmet tregoi maturi. Në situatën e vështirë të atyre ditëve tragjike, struktura shtetërore e xhandarmërisë,

* Xhelal Staravecka, nuk thotë datë të saktë për këtë deklaratë të Bektash Cakranit, por duke qenë se bëhet fjalë para djegies së Mallakastrës, duhet të ketë qenë muaji prill 1943.

¹⁰⁵ Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë...*, f. 252.

¹⁰⁶ *AQSH*, F. 152, V. 1943, D. 95, fl. 11. Shkresë e bashkisë Përmet, dërguar Zyrës Politike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, dt. 26.7.1943.

¹⁰⁷ *Po aty*, F. 153, V. 1943, D. 295, fl. 99. Procesverbal i mbajtur në zyrat e komandës së xhandarmërisë Përmet, datë 7 korrik 1943, dërguar komandës së përgjithshme të xhandarmërisë.

luajti një rol të rëndësishëm pozitiv në kontrollin e situatës, në dobi të popullsisë civile. Po të mos ishin këto forca, procesi i pafrenueshëm në ato situata të vështira, do të kishte degjeneruar në imoralitet, sidomos në vjedhje e çnderime. Sipas një raporti të komandës së xhandarmërisë së Përmetit, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, korrik 1943, autoriteti i forcave të rendit, u duk qartë, kur të rinjtë dhe të rejat mbetën rrugës për shkak të djegies dhe gjetën strehë në godinën e xhandarmërisë. Ata u mbrojtën të paprekur, në sajë të togerit Rexhep Beqiri dhe xhandarëve të tjerë, të cilët u sollën me vajzat përmetare, si vëllezër të vërtetë.¹⁰⁸

Pas dështimit në këtë operacion ushtarak, komunistët u hodhën në sulm kundër forcave nacionaliste. Por, edhe këta të fundit nuk i kursyen akuzat ndaj tyre. Secili krah mundohej, që me anë të akuzave dhe justifikimeve të ndërsjellta, të përfitonte politikisht dhe moralisht. Përfaqësuesit e organizatës së Partisë Komuniste për Përmetin, bënë përgjegjëse forcat e Ballit Kombëtar. Në analizën që i bënte komanda e operacionit të Përmetit, kësaj beteje, arrinte në përfundimin, se po të kishin luftuar gjithë palët, italianët nuk mund të kalonin. Aty kishin qenë dhe shumë forca të kryesura nga kapiten Karafil Zhepova, të cilat luftuan ashpër në datën 2 korrik, ndërsa në datën 4 u larguan.¹⁰⁹ Sipas kësaj komande, Karafil Zhepova, pas një bisede të gjatë që kishte pasur dy ditë më parë me Xhelal Staraveckën, kishte deklaruar, se forcat e Ballit do të luftonin bashkë me partizanët, deri në pikën e fundit të gjakut, por në fakt, ishin tërhequr.¹¹⁰ Për Staraveckën, edhe pse ballistët ishin shprehur kundër goditjes së italianëve, për të shmangur mundësinë e djegies së qytetit e fshatrave, okupatori nuk bëri asnjë dallim të ruante të vetët dhe të ndëshkonte armiqtë, kështu që, nuk kurseu as Cakranin në Mallakastër dhe as Këlcyrën e Përmetin.¹¹¹

Dashnor Mamaqi, një nga pjesëmarrësit e këtij aksioni, akuzonte Ballin Kombëtar si shkaktar kryesor të disfatës. Ai i shkruante Qarkorit të Gjirokastër, se më 4 korrik, kishin marrë detyrë të kalonin në anën tjetër

¹⁰⁸ *Po aty*, F. 152, V. 1943, D. 95, f. 11 Shkresë e bashkisë Përmet, dërguar Zyrës Politike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, dt. 26.7.1943.

¹⁰⁹ *Po aty*, F. 67/APL, V. 1943, D. 5, fl.6. Raport i Komandës së Vendit Përmet, datë 5 korrik 1943, dërguar Komandës së Operacionit (Zona e I-rë Operative Vlorë-Gjirokastër).

¹¹⁰ *Po aty*.

¹¹¹ Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë...*, f. 252.

të Vjosës, për të zënë pozicione në Grykën e Këlcyrës. Por ky aksion kishte dështuar, pasi sipas tij, Vinçi ishte marrë në dispozicion të Ballit. Ata nuk i kishin lejuar partizanët të kalonin lumin, madje patën bllokuar edhe vahun e Këlcyrës. Si organizator të këtyre veprimeve, Mamaqi bënte përgjegjës Muhamet Polin dhe Xhemali Këlcyrën. Në raportin e tij, ai shkante edhe më tej, duke akuzuar përfaqësues të Ballit, si bashkëpunëtorë të drejtpërdrejtë të italianëve, pasi, “Sali bej Këlcyra, kryetar i këshillit të Ballit, Muhamet Poli dhe Xhemali Këlcyra, më 2 korrik 1943, kishin shoqëruar për në pozicionet e partizanëve, që luftonin në Kuqar, rreth 100 ushtarë italianë, që mundën të kapërcenin Grykën e Këlcyrës”.¹¹²

Ndërsa bashkia e Përmetit, e gjente shkakun e tragjedisë së ndodhur te “kokëfortësia e djalërisë sonë” e cila provokoi në mënyrën më tragjike, djegien e “pjesës më të madhe dhe më ideale të Përmetit”.¹¹³

Edhe nacionalistët e krahinës së Rëzëz*, e shpjegonin masakrën e Përmetit, me argumentin, se në kohë lufte, çdo ushtri ka të drejtë të hakmerret për dëmet që i shkaktohen.¹¹⁴ Sipas tyre, faji u takonte komunistëve, sepse po të mos ishin lejuar aksione të pastudiuara në atë krahinë, nuk do të kishin ndodhur pasoja të tilla. Për të gjitha këto arsye, ata akuzonin çetat partizane “si shkaktarë të djegieve”.¹¹⁵

Debatet vijuan gjatë dhe secili krah vazhdonte të qëndronte në pozicionin e vet. Secili kishte këndvështrimin e tij për “tokën e djegur” të Përmetit. Komisari i çetës “Musa Fratari”, në një letër dërguar qarkut Gjirokastër, lidhur me djegien e Përmetit, shkruante, se ishin “mbushur shpellat me familje”.¹¹⁶ Por, ai nuk e konsideronte të jashtëzakonshme këtë situatë. Në letrën e tij vijonte, se “jemi në luftë dhe lufta i ka këto”. Komisari ishte më i shqetësuar për vlerësimin politik të ngjarjeve, ndaj pohonte, se duhej t’u jepnin zemër njerëzve dhe t’u krijonin bindjen atyre, se “liria nuk mund të fitohej pa sakrifica” dhe se me fitoren e lirisë, shtëpitë e shkrumbuara nga armiku, do të rindërtoheshin dhe do të

¹¹² Nuri Dragoj, *Penë dhe pushkë për mëmëdhenë*, Tiranë 2006, f. 396.

¹¹³ *AQSH*, F. 152, V. 1943, D. 95, fl. 11 Shkresë e bashkisë Përmet, dërguar Zyres Politike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, dt. 26.7.1943.

* Rëza është krahinë në rrethin e Përmetit dhe përfshin fshatrat e vendosura në krahun e majtë të rrjedhës së Vjosës, buzë Nemërçkës.

¹¹⁴ Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të historisë...*, f. 251.

¹¹⁵ Apostol Kotani, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në rrethin e Përmetit*, Tiranë: 1969, f.100.

¹¹⁶ *Përmeti gjatë luftës...*, f. 239.

bëheshin më të bukura.¹¹⁷ Por, nacionalistët e dinin që riparimi i dëmeve të shkaktuara nga djegiet do të kërkonte vite. Një gjë të tillë e kishin përjetuar edhe më parë, gjatë djegieve të bëra nga grekët në vitin 1914.

Sipas partizanëve, djegia e qytetit u bë me qëllim, që shqiptarët të hiqnin dorë nga Lufta Nacionalçlirimtare. Fashistët e kishin dhënë urdhrin për djegien e qyteteve, që ngjarje të tilla të mos përsëriteshin më.¹¹⁸ Në këtë kuadër, propagandohej ngado, se barbarizmat e kryera, “nuk ishin shenja të forcës por të dobësisë së tyre”.¹¹⁹ Madje, kishte edhe nga ata, që shpreheshin në mënyrë euforike, se ngjarja në fjalë ndodhi, për shkak se italianët ishin “kapur si minjtë në grackë nga çetat partizane”.¹²⁰ Të tjerë mendonin, se ky aksion kishte pasur vlera të mëdha, pasi e detyroi komandën italiane t’i tërhiqte përkohësisht repartet e saj. Por, pak më vonë, për shkak të rëndësisë strategjike që kishte Përmeti, në fund të muajit korrik 1943, vendosi sërish në Përmet e Këlcyrë nga një batalion të Divizionit “Perugia”¹²¹.

Operacioni i organizuar për mësymjen e Kuqarit dhe të Përmetit, duke u vlerësuar nga numri i forcave pjesëmarrëse, shtrirja e territorit ku u zhvilluan luftimet dhe kombinimet taktike të përdorura, ishte vlerësuar si aksioni më i madh i organizuar deri në atë kohë, nga forcat partizane, në gjithë vendin.¹²² Ky aksion vlerësohej dhe për përvojën luftarake të fituar nga forcat partizane, të cilat tashmë duhej të kalonin drejt organizimit të një ushtrie të rregullt nacionalçlirimtare. Për krerët e komandës së Përmetit, nëse populli shqiptar do të nënshtrohej, kjo do të ishte fatkeqësia më e madhe.¹²³

Fakti që, qindra familje humbën njerëz, shtëpi e pasuri dhe kishin mbetur shpellave pa asnjë burim jetese, e kishte acaruar klimën

¹¹⁷ *Po aty*.

¹¹⁸ *AQSH*, F. 149, V. 1943, D. III-839, fl. 173-174. Shkresë e MPB dërguar kryeministrit, sipas informacionit të marrë nga komanda e xhandarmërisë, qarku Gjirokastrë, i cili bazohej në procesverbalin e datës 7 korrik 1943, mbajtur në zyrën e sekretarit të Komandës së Xhandarmërisë Përmet, mbi ngjarjen e datës 6 korrik, firmosur nga sekretari nënprefekturës Xhaferr Mehmet.

¹¹⁹ *Përmeti gjatë luftës...*, f. 249.

¹²⁰ Behar Shtylla, *Kongresi Përmetit, kongresi i popullit në fuqi*, Tiranë: 1979, f. 150.

¹²¹ Xh. Frashëri, *Lufta e armatosur e popullit shqiptar ...*, f.126.

¹²² *Po aty*, f. 125.

¹²³ *Përmeti gjatë luftës...*, f. 251.

antikomuniste. Më 11 korrik, Xhelal Staravecka, në një letër për Tahir Kadarenë shkruante, se ishin thelluar kontrakditat midis partizanëve dhe ballistëve. Njerëzit ishin revoltuar, për shkak të djegies së dy qyteteve dhe shumë banesave në fshatra. Duke qenë prezent në paralajmërimet e bëra nga Balli, se “fashistët do të na djegin, në rast se i godasim”, fshatarët e shihnin të keqen te partizanët e ardhur nga Skrapari dhe Kurveleshi. Sipas letrës së Staraveckës, në krahinën e Dëshnicës, kishte tri ditë rresht që bëheshin mbledhje pas mbledhjesh, “për të na larguar që këtej”.¹²⁴ Një ditë më parë, me vendim të prerë, banorët u kishin komunikuar me anë komisionesh, që duhej të largoheshin sa më parë nga krahina. “Sadoqë ngulmova - kujtonte Staravecka - nuk qe e mundur. Ai u kishte kërkuar të vendoseshin disa kushte dhe të vazhdonin të qëndronin në atë krahinë, por ata nuk ishin bindur, duke qëndruar të palëkundur në vendimin e tyre. Madje, pretendonin, se do të arrinin “deri në shpërthim zjarri, në rast se nuk largoheshim”.¹²⁵ Pleqësia e krahinës së Dëshnicës, i kishin drejtuar një letër edhe Xhemal Malindit, e cila nënshkruhej prej këshillave të shumë fshatrave, ku i kërkonin me çdo kusht të largoheshin nga krahina.¹²⁶

Kërkesën e dëshnicarëve për largimin e partizanëve nga krahina, për shkak të fatkeqësive që ndodhën, komunistët e konsideronin si qëndrim “krejt tradhëtar”.¹²⁷ Ndaj, Staravecka porosiste Xhemal Malindin, të largoheshin nga Dëshnica që atë mbrëmje, pasi nuk kishte rrugë tjetër dhe shtonte, se nesër do të largoheshin edhe ai vetë.¹²⁸ Xhelali i kërkonte Kadaresë, t’i shkruante dhe ta informonte edhe për Shaqir Kapinovën, për të cilin nuk kishte lajm dhe i lutej që, nëse kishte për t’i shkruar, letra duhej të mbërrinte të nesërmen në mëngjes, pasi ai do të largoheshin nga krahina e Dëshnicës.¹²⁹

Të nesërmen, në një tjetër letër, drejtuar Tahir Kadaresë, Staravecka informonte komandën, se po largoheshin nga ajo krahinë, në drejtim të Therepelit. Por, nuk e shihte normale zbrazëtinë e krahinës së Dëshnicës nga komunistët. Ndaj propozonte, që Feti Bubësi, ndonëse nuk

¹²⁴ *AQSH*, F. 67/APL, V. 1943, D. 5, fl. 29. Letër e Xhelal Staraveckës, dërguar Tahir Kadaresë, datë 11 korrik 1943.

¹²⁵ *Po aty*.

¹²⁶ *Po aty*.

¹²⁷ *Po aty*.

¹²⁸ *Po aty*.

¹²⁹ *Po aty*.

e kishte çetën aty, ishte mirë të qëndronte në Dëshnicë. Një çetë ishte e nevojshme të shërbente si roje e fshatrave dhe ndërlidhës me forcat e Skraparit, për çdo eventualitet që mund të ngjaste.¹³⁰

Veç kësaj, ai sillte në vëmendje faktin, që në Qafën e Këçokut, kishin mbetur shumë materiale. Me largimin e ushtrisë italiane, këto materiale duhej të merreshin prej partizanëve dhe të bëhej kujdes të mos binin në duar të ballistëve.¹³¹

Si përfundim, mund të themi, se beteja për çlirimin e Përmetit, tregoi dy elemente thelbësore të luftës: nga njëra anë, u panë konkretisht pasojat e rënda që vijnë për shkak të egërsisë së saj. Nga ana tjetër, u dëshmuar, se strategjia partizane, jo rrallë herë nënvleftësonte koston e lartë që duhej të paguante popullsia civile për aksionet partizane kundër trupave ushtarake italiane. Sulmi rrufe mbi ta dhe largimi i menjëhershëm nga vendi i ngjarjes, i formacioneve partizane të lëvizshme, bënte që hakmarrja e pushtuesit të binte pikërisht mbi banorët vendës, ku zhvilloheshin luftimet.

Kjo ishte një praktikë e njohur gjatë luftës, por për çudi, nuk merrej parasysh nga drejtuesit komunistë, të cilët ishin pa përvojë në çështje luftarake. E njëjta gjë kishte ndodhur më 15 prill 1943, kur forcat operative të Korparmatës IV, i vunë zjarrin Kurveleshit, për shkak të një masakre që kishte bërë Mehmet Shehu, ndaj disa oficerëve italianë.¹³² Historiografia jonë, nuk mund ta lërë jashtë vëmendjes faktin, që ka qenë Ali Këlcyra, personi që hyri në Gjirokastër, sapo pa tymin dhe flakët mbi shtëpitë e qytetit dhe i deklaroi komandës fashiste, se po të mos ndalej zjarri, i gjithë populli do të rrëmbente armët. Në një rast të tillë, përgjegjës për fatkeqësitë që mund të ngjanin do të ishin vetë ata.¹³³

Të njëjtin qëndrim mbajti Ali Këlcyra edhe në takimin që pati me Mehmet Shehun, te Rrapi i Dervenit, në afërsi të Tepelenës. Ai, i tha popullit publikisht, se nacionalistët ishin për luftën kundër italianëve dhe dëshironin ta shporrnin atë sa më parë, por duke ruajtur dhe popullin. Ne, nuk mund të veprojmë si Mehmet Shehu me shokë – deklaronte ai – që me porosinë e Dushan Mugoshës, goditnin italianët dhe fshiheshin pyjeve

¹³⁰ *Po aty*, f. 28.

¹³¹ *Po aty*, f. 27.

¹³² Ali Këlcyra, *Shënime për historinë e Shqipërisë*, përgatitur nga Tanush Frashëri, Tiranë: “Onufri”, 2012, f. 212.

¹³³ Tanush Frashëri, *Ali Këlcyra, aristokrati kuq e zi*, Tiranë: “Çabej”, 2005, f. 220.

dhe maleve, duke i lënë nuset dhe vajzat shqiptare, të prisnin të tmerruara ushtarët e tërbuar nga zemërimi, prej sjelljes së buracakëve, që bënë shir nga brigjet dhe malet.¹³⁴

Nuk mund të anashkalohet fakti, që lufta midis partive politike në Shqipëri, i kishte kaluar caqet. Ata po e shihnin njëri – tjetrin si armiq, dhe gjithçka lidhej me pushtetin e ardhshëm, pasi të dy palët, e dinin që fundi i luftës ishte i afërt. Në këtë kuadër u bë dhe arrestimi i Ali Këlcyrës, më 11 qershor 1943, te Ura e Kardhiqit. Plani ishte t'i bëhej një gjyq i shpejt partizan dhe të pushkatohej, me qëllim që të shuhej influenca e Ballit në Jug dhe të mbetej forcë e vetme Fronti. Por u ngritën mijëra luftëtarë, që kërkuan lirimin e tij dhe në ato kushte, ai “u lirua nga vet komanda partizane”.¹³⁵

Duke menduar, se përhapja e pikëpamjeve të tilla, kundër veprimeve të çetave partizane, mund të ndalej me anë të dhunës, komunistët arrestuan Papa Aleksin dhe Agathokli Xhitomin, duke i quajtur përgjegjës për klimën e antiluftës, që ishte krijuar në atë krahinë. Tentuan t'u bënin një gjyq ushtarak, por më pas i liruan, me kusht, që “të hiqnin dorë nga veprimtaria e tyre armiçësore”.¹³⁶ Më pas, duke parë që Papa Aleksin nuk hiqte dorë nga mendimet e tij, sipas të cilave, duhej mbrojtur populli nga pasojat e sulmeve guerile të partizanëve, vendosën ta arrestojnë dhe gjykojnë. Por nuk mundën, pasi Papa Aleksin ishte venë në dijeni dhe ishte arratisur në Greqi.¹³⁷

Edhe për djegien e Kurveleshit, komunistët patën fajësuar nacionalistët. Një muaj para djegies së asaj krahine, Bektash Cakrani, i kishte deklaruar Xh. Staraveckës, se me sjelljen që bënte Mehmet Shehu, së shpejti do të shihnin “flakën e djegies së shtëpive, gjësë dhe mallit që ngrihet përpjet në qiell”.¹³⁸ Duke parë këtë skenë, Staravecka shkruante, se Aliu i ishte lutur, të mos shkonte në Dëshnicë apo në Përmet, për të bërë ndonjë aksion, “pse tash sa i kam mbaruar ata dyqane në Këlcyrë dhe mos u bëj shkak të mi djegin”.¹³⁹ Mbi këto dy argumente, Staravecka besonte, se vet nacionalistët kishin bashkëpunuar me pushtuesit për djegien. Natyrisht, ky argument nuk duket bindës, pasi Ali Këlcyra, nuk

¹³⁴ *Po aty*, f. 223.

¹³⁵ A. Kotani, *Lëvizja nacionalçlirimtare...*, f.101.

¹³⁶ *Përmeti gjatë luftës...* f. 252.

¹³⁷ *Po aty*.

¹³⁸ Xh. Staravecka, *Përpara gjyqit të Historisë...*, f. 252.

¹³⁹ *Po aty*, f.216-217.

mund të bashkëpunonte me italianët për të djegur pronën e tij, pasi dihej, që shumica e dyqaneve në treg, u përkiste bejlerëve të Këlcyrës.

Sipas kësaj analize, konkluzioni që del është, se lufta kundër fashistëve italianë në rrethin e Përmetit dhe kudo tjetër, ishte e drejtë, pasi ishte luftë çlirimtare. Nëse Shqipëria nuk do të ishte rreshtuar në krah të aleatëve, fati i saj, i pas luftës, do të vihej në dyshim. Nga ana tjetër, teoria e pritshmërisë apo gjetjes së kohës së duhur, që pretendohej nga ballistët, nuk ishte normale, pasi e nxirrte popullin shqiptar jashtë kërkesave të aleatëve, të cilët këshillonin sulmin e pandërprerë ndaj pushtuesve. Por, taktika e përdorur nga forcat komuniste, pati kosto të lartë për popullin e thjeshtë, pasi u hodhën në luftë, pa llogaritur mirë forcat dhe kundërveprimin e armikut, duke bërë të shkaktohen raprezalje të tilla masive. Për çdo sulm të planifikuar që organizohet në kohë lufte, për cilëndo ushtri qoftë, në bazë të artit ushtarak, bëhen mirë llogaritë dhe vepohet vetëm në ato raste kur fitorja është e garantuar.

Duke e gjykuar qetësisht ngjarjen dhe pasojat që pati, fitorja në këto luftime ishte si “fitorja e Pirros”. Nuk mund të anashkalohen humbjet e mëdha me shprehjen, se “gjithçka justifikohet në luftë”. Gjithsesi, duke analizuar ngjarje të tilla, kuptojmë, që lufta ka ligjet e veta të rrepta, sipas të cilave veprimet e pastudiuara dhe voluntariste, të çojnë në humbje. Në të, barbaria është prezente dhe shoqërohet me plotë viktima. Natyrisht, etika dhe mëshira mbeten për t’u parë vetëm në kohë paqe, kur e vështrijmë ngjarjen nga larg dhe me gjakftohtësi.

Në ato ditë lufte, u ravigjzua qartazi edhe qëndrimi i nacionalistëve. Një pjesë e tyre u bashkuan me partizanët dhe të tjerë qëndruan të tërhequr. Argumenti i tyre për një qëndrim të tillë, ishte eksperiencia e hidhur që kishin patur mbi ndërmarrjen e aksioneve midis forcave të pabarabarta, të cilat shoqëroheshin me pasoja të rënda në popull. Kjo u duk edhe në masakrën e Borovës prej gjermanëve, më 6 korrik, apo të asaj të Zhepës e Draçovës* më 7 korrik 1943, ku u vranë 64 burra. Duke e parë ngjarjen me gjakftohtësi, pas kaq dekadash, rezulton se planifikimi i sulmit përfundimtar, mund të ishte studiuar më me detaje,

* Më 7 korrik 1943, çeta partizane e Rrëzës sulmoi një skuadër gjermane, në afërsi të urës së Peratit, ku përveç dy ushtarëve të pararojës, u vranë dhe disa të tjerë. Pas kësaj, forcat gjermane hynë në fshat, kapën 64 burra të cilët i pushkatuan në vend dhe dogjën fshatrat Perat, Vllaho-Psilloterë e Biovizhdë dhe më vonë edhe fshatrat Zhepë e Draçovë. Një ditë më parë kishte ndodhur masakra e Borovës, ku u vranë 107 burra dhe u dogjën disa fshatra.

në mënyrë që të shmangej tragjedia e popullsisë civile, gjë të cilën e ka pranuar dhe vetë komanda e operacionit. Nga ana tjetër, deri tani, çështja është analizuar ideologjikisht, duke i parë ballistët vetëm si “dele të zeza”. Të paktën, për rrethin e Përmetit, kur thuhet se ballistët kishin frikën e djegies së qendrave të banuara, ndaj kërkonin maturi në sulmin ndaj italianëve, nuk duhet interpretuar thjesht, si deri më sot, se ishin “frikacakë”. Maturia nuk tregon frikë, por dituri. Besoj se, qëndrimi ngurues i nacionalistëve, ndaj fillimit të aksionit të Përmetit, lidhej, jo thjesht me analizën luftarake të situatës, por mbi të gjitha, me përgjegjësinë e tyre përpara bashkëfshatarëve apo bashkëqytetarëve të vet, mes të të cilëve jetonin dhe vepronin.

S u m m a r y

THE STRUGGLE OF PERMET. THE BURNINGS AND CONSEQUENCES (JULY 1943)

Burning down the towns of Kelcyre and Permet on the 5th and 6th of July 1943, is considered to be one of the most cruel barbarities of the Italian occupation army. After the attack on Peza, the Albanian forces planned an attack on the Italian garrisons in Permet, Kuqar and Kelcyre, in order to neutralize them and to bring an end to the attack on Mallakaster. However, after five days of fighting in the three above mentioned places, the Italians broke the siege with the help of other forces which arrived from Berat and in the afternoon of 5th July they set fire to the town of Kelcyra. The next morning they set fire to Permet as well. Along with human loses, were burned down 137 stores, hundreds of offices and houses, among which 125 newly built houses in Varosh quarter.

With regard to the attack against the Italian forces, there were a lot of discussions between the political groups in the prefecture. Leaders of the partisan forces thought that blocking the entrance of Permet would force the Italian battalions to surrender within a short time. On the other hand, the nationalist forces thought that the Italian army was still strong, thus they should not hurry. They believed that they needed to plan and calculate everything before starting the attack.

Another issue which led to contradictions was the attitude towards the gendarmerie. The nationalists wanted to fight the occupation forces but at the

same time they wanted to preserve the institutions of public order, which would ensure order and safety for the population. This way, the men would have a guarantee that their families would be protected and they could pick up arms. Meanwhile, the communists had as their motto the fight against the government and propagated not to enroll “any gendarme or soldier” for the state. Their objective was to seize power, to take full control of everything including the local administration.

